



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 1594 / prot. 112

Tiranë, më 20/05/2021

URDHËR
Nr. 183/4, datë 20.05.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHURIN NR. 633 DATË 17.11.2020

“PËR NDALIMIN E GRUMBULLIMEVE NË VENDE TË MBYLLURA APO TË HAPURA” TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, të Ligjit Nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019, si edhe Vendimit të Komitetit Teknik nr. 1594/9 datë 05.05.2021,

URDHËROJ:

Në Urdhrit Nr.633, datë 17.11.2020, “Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura” të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1 të Urdhrit, togfjalëshi “deri në datën 20.05.2021” zëvendësohet me togfjalëshin “deri në një urdhër të dytë”.
2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren Zyrtare”.

MINISTRI

Ogerta Manastirliu

